

## **AKTI THEMELIMI**

### **I**

## **SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

### **“GES GERMAN-ENERGY-SOLUTION” SHPK**

Sot me datë 27/ 04/ 2024, Z. Argi Llanaj, shtetas shqiptar, i datëlindjes 09.10.1982, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Numër Personal I21009038E, Znj. Katharina Windus, shtetase gjermane, e datëlindjes 20.08.1984, lindur në Eschwege dhe banues në Eschwege, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Numër Personal L63N25ZZR dhe Z. Torben Richard Putz, shtetas gjerman, i datëlindjes 18.06.1982, lindur në Frankfurt Am Main dhe banues në Frankfurt Am Main, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me Numër Personal L5WNNH91V vendosën të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe në përputhje me dispozitat vijuese.

#### **NENI 1**

##### **Themelimi**

Emri i shoqërisë është “GES GERMAN-ENERGY-SOLUTION” SH.P.K.

Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brëndshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri “GES GERMAN-ENERGY-SOLUTION” SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi si dhe në Statutin vijues.

#### **NENI 2**

##### **Qëllimi i krijimit të shoqërisë**

Qëllimi i krijimit të kësaj shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme, të cilat do të përcaktohen në Statutin e saj. Veprimtaria e kësaj shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

#### **NENI 3**

##### **Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “GES GERMAN-ENERGY-SOLUTION” SHPK. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

#### **NENI 4**

##### **Objekti i veprimtarisë**

## Pershkrimi i Aktivitetit

- Tregti dhe prodhim per produktet elektrike te automjeteve te cdo lloji, karikues elektrike, fast charger dhe cdo pjese tjeter elektrike qe ka lidhje me fushen e elektromobilitetit.
- Konsulence dhe trajnime per perdorimin e produkeve elektrike te automjeteve te cdo lloji.

## NENI 5

### Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia ligjore e Shoqërisë është në adresën rruga e Kavajes, hyrja 6, Tirane, njesi me nr 1/301+6-N18,ZK.8260.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## NENI 6

### Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 450,000 (katerqind e pesedhete mijë) Lekë, i ndarë në 3 kuota me vlerë nominale të kuotave perkatesisht prej 148,500(njeqind e dyzete e tete mijë e peseqind) Lekë, 148,500(njeqind e dyzete e tete mijë e peseqind) Lekë dhe 153,000(njeqind e pesedhete e tre mije) Leke.

Ortakët themelues të shoqërisë Tregtare “GES GERMAN-ENERGY-SOLUTION” SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Z.Argi Llanaj, zotërues i 33 % (tridhjetë e tre) të kapitalit (kuotave) të shoqërisë, me vlerë 148,500(njëqind e dyzete e tete mijë e peseqind) Lekë.

Znj.Katharina Windus, zotërues i 34 % (tridhjetë e kater) të kapitalit (kuotave) të shoqërisë, me vlerë 153,000(njëqind e pesedhete e tre mijë) Lekë.

Z.Torben Richard Putz, zotërues i 33 % (tridhjetë e tre) të kapitalit (kuotave) të shoqërisë, me vlerë 148,500(njëqind e dyzete e tete mijë e peseqind) Lekë.

Kapitali themeltar është shlyer plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve të tyre në kapitalin themeltar.

## **NENI 7**

### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, date 14/04/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi me i lartë vendimarrës;

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## **NENI 8**

### **Administratori**

Shoqëria administratohet nga Administratori i cili zgjidhet për një mandat pesë vjecar me të drejtë rizgjedhje. Administrator i shoqërisë do të jete Z.Argi Llanaj. Shoqëria përfaqësohet para cdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## **NENI 9**

### **Të tjera**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë cdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statuti.

## **NENI 10**

### **Ruajtja e sekretit**

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## **NENI 11**

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata Kompetente.

## **NENI 12**

### **Nënshkrimi**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa verejtje.

Ky akt Themelimi hartohet në 4 kopje në gjuhën shqipe.

**ORTAKET THEMELUES**

**Z.Argi Llanaj**

**Znj.Katharina Windus**

**Z.Torben Richard Putz**